Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0454

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " BAK - ING " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi, montimi i filtrave në njësit e trajtimit ajrit në ndërtesat Qeveritare me numër të prokurimit 214-23-3982-1-2-1, me 17/08/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“BAK-ING” SH.P.K. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 03.07.2023 (me numër protokolli 454/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi, montimi i filtrave ne njësit e trajtimit ajrit ne ndërtesat Qeveritare “ me nr. të prokurimit: "214-23-9382-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Puneve te Brendshme.

2. Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

3.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 27.04.2023, Ministria e Puneve te Brendshme, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi, montimi i filtrave ne njësit e trajtimit ajrit ne ndërtesat Qeveritare" Me nr te prok:”214-23-9382-1-2-1”. Nderkaq me datën 14.06.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE“BAK-ING” SH.P.K me datën 19.06.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 23.06.2023, AK- Ministria e Puneve te Brendshme ka marre vendim se eshte pjesërisht e bazuar per rishqyrtim te OE "BAK-ING"Group SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi i filtrave ne njësit e trajtimit ajrit ne ndërtesat Qeveritare" me numër te prokurimit: 214-23-9382-1-2-1 inicuar nga Ministria e Puneve te Brendshme.

AK ne vendim ka kërkuar te mbetet ne fuqi njoftimi mbi vendimin per dhënie i AK –Ministria e Puneve te Brendshme lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi i filtrave ne njësit e trajtimit ajrit ne ndërtesat Qeveritare" me numër te prokurimit: 214-23-9382-1-2-1.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues"BAK-ING" SH.P.K me datën 03.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 454/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës:70,000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 10.07.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Grupit të OE "BAK-ING" SH.P.K.

Të aprovohet si e bazuar, si dhe **të anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

<u>Sqarim hyrës</u> - Fillimisht sqarojmë se OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 19.06.2023 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 23.06.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues dhe në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. Andaj, në vijim janë dhënë përgjigjet numër 1 dhe 2 për pretendimet që lidhen me arsyet e eliminimit të OE ankues dhe përgjigja numër 3 që ka të bëjë me pretendimin ankimor për ofertën e OE të rekomanduar.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 1</u> - OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, në lidhje me arsyetimin e dhënë në vendimin e AK-së të datës 14.06.2023 ku AK konstaton se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën 11.1 të dosjes së tenderit. AK në vendimin e datë 14.06.2023, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ka dhënë arsyetimin për eliminimin e OE ankues si vijon:

- *Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre ne grup dhe se ata nuk marrin pjese ne mënyrë individuale dhe/apo ne ndonjë grup tjetër pjesëmarrës ne procedurën e njëjtë te prokurimit;*
- *Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga te gjithë anëtarët e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës te veproj ne emër te grupit;*

Në dosjen e tenderit të publikuar nga AK tek Krijimi i grupi të OE-ve, përkatësisht kërkesa 11.1 specifikohet se në rast të ofertim si grup i OE-ve atëherë duhet të dorëzohen:

a. *një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës*
b. *një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;*
c. *një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe*
d. *të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.*

OE ankues ka dorëzuar deklaratë në gjuhën angleze e cilat është e dedikuar për këtë aktivitet të prokurimit dhe përshkruan palët nënshkruese dhe përshkrimin e konfirmimeve për pikat sipas nenit 11.1 të dosjes së tenderit. Dokumenti është i nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesit e dy palëve. Eksperti sqaron se AK nuk ka marrë për bazë deklaratën e dorëzuar nga OE ankues përkundër që në nenin 26.2 të RrPP thuhet se: "*Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument*". Andaj, arsyetimi i eliminimit lidhur me deklaratat e anëtarëve të grupit të OE-ve është i paqëndrueshëm meqë AK në arsyetim konstaton mungesën e deklaratave në kundërshtim me nenin 26.2 të RrPP-së.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 2</u> - OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, në lidhje me arsyetimin e dhënë në vendimin e AK-së të datës 14.06.2023 sa i përket certifikatës së regjistrimi të biznesit për anëtarin e grupit "TEKFIL FILTRE SAN. VE TIC. A.S". AK në vendimin e datë 14.06.2023, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ka dhënë arsyetimin për eliminimin e OE ankues si vijon: "*Anëtari i konzorciumit "TEKFIL FILTRE SAN. VE TIC" A.S ka dorëzuar një dokument ne gjuhen turke që nuk e dimë a është Certifikatë c regjistrimit te biznesit apo certifikatë e të hyrave tatimore vjetore, edhe pse ne kemi mundur te kërkojmë informata shtese sipas nenit 59.2 dhe 72.2 te LPP-se, nuk e kemi përdorur ketë mundësi, për arsye se konsiderojmë se edhe pas plotësimit te mundshëm te dokumentacionit nga ju, nuk do te ndryshonte gjendja ne renditjen e ofertuesve, pasi qe kemi oferte të përgjegjshëm me çmimin me të lirë se oferta juaj gjithashtu ky tenderues eliminohet për arsyeje tjera te cekura me lartë.*".

Grupi i OE-ve ka dorëzuar dy dokumente si certifikata të regjistrimit; Certifikatën e regjistrimit të biznesit të anëtarit "BAK-ING" Sh.P.K, me numër unik identifikues 810116211, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia e Regjistrimit Bizneseve në Kosovë. Gjithashtu ka dorëzuar edhe dokumentin e emërtuar "Certifikata e Biznesit – Tekfil" e cila është në gjuhën turke. Eksperti sqaron se në lidhje me gjuhën e dokumenteve të dorëzuara, në LPP dhe RrPP nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së. Megjithatë, KRPP ka dhënë opinion me datë 22.06.2023, në lidhje me pyetjen "*Si duhet të veprojë AK, në rast se një tenderues paraqet ndonjë dokument të tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së?"*. Në përfundim të opinionit të dhënë nga KRPP thuhet "*..Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument."*. Më tej në nenin 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik (UPP) në tabelën e shembujve në rastin kur mungon Certifikata e regjistrimit të biznesit, AK udhëzohet se mund të kërkohen informata sqaruese. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, AK nuk ka kërkuar sqarime lidhur me certifikatën e regjistrimit të biznesit për anëtarin e grupit, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 3</u> - OE ankues pretendon se AK ka rekomanduar shpërblimin me kontratë OE i cili ka ofertuar çmimin jonormalisht të ulët pa aplikuar procedurën e përcaktuar me RrPP. AK në vendimin e datë 14.06.2023, ka rekomanduar shpërblimin me kontratë për OE N.P."Bosch me seli në Mitrovicë, ne vlerë totale të ofertës (pas korrigjimit te llogaritjes aritmetikore) në shumë prej 34,338.60 €. Sipas nenit 41.3 te RrPP, AK kërkon nga OE për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet si vijon:

çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë

Më tej në nenin 41.6 thuhet: "*Në rast se një duket të jetë jo normalisht i ulët, AK <u>duhet</u> të kërkoj me shkrim nga OE i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët"*. Pra, është e domosdoshme aplikimi i procedurës inter partes me OE. Më tej eksperti sqaron se janë plotësuar kriteret e pacaktuara me nenin 41.3 të RrPP për tenderuesin jonormalisht të ulët për OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa sipas shkresave të lëndës AK nuk ka zbatuar procedurën inter partes me OE të rekomanduar për kontratë, që do të duhej ta bëjë sipas dispozitave të sipërpërmendura. Andaj, duke u bazuar në sqarimet e sipërpërmendura, eksperti sqaron se pretendimi ankimor është i bazuar.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe duke u bazuar në interpretimin e KRPP, mbështet rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 61 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në

mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **" BAK - ING " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: